

## ETIMOLOGJIA

*Qemal MURATI*

Prishtinë

KUD: 809.198.3:801.54

Punim studimor

*Përmbajtja e shkurtër:* Në këtë punim autori polemizon me diletantë e «guximtarë», qofshin ata shqiptarë, qofshin ata sllavomaqedonas, të cilët në kundërshtim me rregulla e ligje gjuhësore, duke u mbështetur vetëm në përgjasime fonetike të rastit dhe me spekulacione aventuroze përpiqen të «zbardhin» etimonin e një fjale.

Etimologjia (prej gr. *étymos* «i vërtetë, prejardhje, kuptim» dhe *-logia* «shkencë»), e cila merret me prejardhjen e fjalëve, është njëra nga disiplinat më tërheqëse, por dhe më të vëshira të gjuhësisë – për shkak të kompleksitetit quhet dhe «punë e zezë» (bull, *černija trud*), e cila është e lidhur ngushtë me shumë drejtime e gjuhë të ndryshme dhe me shumë fusha shkencore (historinë, gjeografinë, mitologjinë, botanikën, zoologjinë, kiminë etj.). Qëllimi themelor i etimologjisë është gjetja e arketipit, domethënë formës së kryehershme me mjete të gjuhësisë historike (Zh. Bojaxhiev, *Uvod v ezikoznaniето, Plovdiv*, 1997).

Rreth një fjale që merret si objekt hulumtimi, etimologjia i huazon elementet e saj të informimit edhe nga fonetika, edhe nga morfologjia, edhe nga semantika, etj. (F.Sosyr, *Kurs* 288). Paul Kreçmeri në metodën e gjurmimit etimologjik formuloi parimin shkencor: *Një etimologji qëndron në qoftë se është e argumentuar mirë fonetikisht dhe morfologjikisht e gjithashtu edhe për sa i përket kuptimit (Die Sprache 123; E.Çabej, Fonetika historike 82).*

Etimologjia nuk kënaqet me shpjegimin e fjalëve të veçuara, ajo bën historinë e familjeve të fjalëve, ashtu siç bën edhe historinë e elementeve formuese, parashtesave, prapashtesave, etj. (F.Sosyr, *Kurs* 287)

Në etimologji shpesh bashkëveprojnë dy tendenca kundërshtuese: shpjegimi i prejardhjes së fjalës nëpërmjet të ashtuquajturës *mendje e shëndoshë* dhe gjykimit të rreptë shkencor.

*Tendenca për të shpjeguar një fjalë të vështirë duke e lidhur me diçka të njohur – ky fenomen u quajt etimologji popullore* (Sosyr), dhe ka për autorë diletantët – ata me njohuri të cekëta gjuhësore që nuk e vrasin mendjen fort për ligjet historike të gjuhës, por që mbështeten në përngjasime fonetike të rastit.

Për sa i përket karakterit të barazimeve, të rrjedhës së një fjale nga një tjetër, në parim më fort se të ashtuquajturat *barazime rrënjësh* peshojnë ato që quhen *barazime fjalësh* (Çabej). Kësisoj, po t'i sillemi etimologjisë së fjalës trëndafil (gr. triantafilos «tridhjetëfletësh», (shpjegimi vetëm i një pjese të fjalës do të na çonte te sll. *trn* «ferrë») (po pjesa tjetër: «dafil»?).

### **Etimologjia «patriotike»**

Etimologji nuk është një me hetimin e gurrës së një fjale me gjykime arbitrare, me kapërcim nga gjendja e sotme drejtpërdrejt te gurra primare e fjalës me kapje pas elementesh të pakapshme. Ajo përfshin diçka më tërësore dhe duhet t'u mbahet elementeve që janë të qarta e të sakta (Çabej).

Me këtë rrugën e parë në kërkimet etimologjike të shqipes, sidomos në fushën e onomastikës – të gjuhës së emrave të vendeve e të familjeve janë përzier e përzihen shpeshherë njerëz që nuk e dinë gjuhën aspak, që nuk i njohin ligjet dhe rregullësitë e zhvillimit të fonetikës dhe gramatikës historike.

Diletantët e «guximshëm», që s'çajnë kokën për rregulla e për ligje gjuhësore, i kanë krijuar vetes një fushë të lirë arbitrariteti dhe me spekulacione aventuroze përpiqen ta «zbardhin» etimonin e një fjale jo si është jo në të vërtetë – por siç dëshirojnë ata të jetë pas mendjes së tyre. Me «metoda» të tilla ata ngrihen kështu kundër parimit të drejtë shkencor, të disa rrymave linguistike, për t'i veshur fondit të trashëguar huazimet e qarta nga gjuhët e tjera. Një metodë të tillë pseudoshkencore e kishte kundërshtuar rreptë prof. Çabej, sepse kjo nuk është aspak dobiprurëse.

Parimi i pare e i fundit aksiomatik në etimologji është të krahasohen fjalët që janë të krahasueshme midis tyre (Çabej). E bash të kundërtën bëjnë disa të vetëquajtur «etimologë» – krahasojnë çdo gjë me gjithçka..

Të joshur nga sirena e njëfarë akordi formal fonetik (tingullor), ata shkojnë e afrojnë emrin e masivit malor *Ballkan* me fjalët shqipe *ballëkanë*, paçka se dihet botërisht se emri Ballkan i gadishullit të botës mesdhetare është një fjalë turke që do të thotë «mal, malësi». Ky është një term orografik i kalkuar (përkthyer) nga sll. *Stara Planina*, të cilin e ka përdorur i pari në literaturën shkencore gjeografi gjerman August Cojne më 1809, në vend të emërtimeve të mëparshme *Turqia evropiane*, *Gadishulli Ilirik*, *Gadishulli Grek*, *Evropa juglindore*, për këtë siujdhesë.

Po me këtë rrugë, pra me spekulacione të pafre, merren e shpjegohen edhe një varg topikësh, kryesisht emra fshatrash, në disa botime monografike të disa autorëve tanë, të cilët përpiqen t'ia veshin fondit të trashëguar autokton çdo emër vendi, gjoja në kuptimin e asaj se po i sjellin diçka të mirë albanologjisë; e në të vërtetë ata bëjnë karikaturë me shqipen dhe i sjellin dëm të madh asaj.

Zelltarët e «etimologjive patriotike», njerëz që nuk e dinë gjuhën aspak, afrojnë p.sh. emrin e *Ladorishtit* – fshat në rrethinat e Strugës, me fjalë-fjalinë *La doriu* (barrën) (K. Murtishi, *Ladorishti – Historia dhe tradita*, Strugë, 2001) ose me it. *lado* «liqen», *Veleshtë* – fshat i Strugës, me *vjel* (Z. Qyra, *Veleshta në histori*, Strugë 2000), *Zagraçan* – fshat i rrethit të Strugës, me *zagari qan* (I. Baftijari, *Jeta në gur*, monografi e fshatrave Zagraçan dhe Shum, 1999), *Strimnicë* – fshat në rrethin e Tetovës, me *strem-nisa* «lëvroj tokën thellë për të mbjellë vreshtë» (N. Abdiu, *Strimnica*, Tetovë, 1999), *Goshincë* – fshat i Kumanovës, me fjalën *ngushticë* (M. Ismaili, *Goshinca e Kumanovës*, monografi, Shkup, 1998) etj. Zbërthime linguistike shqipezeza janë dhe ato të tipit: *Sicilia* < sicili, secili, *Sparta* < spartim, spastrim, *etrusk* e+tru+s+k e truallit të Trojës, *Fardon* < fara janë, *Lisabon* < lisa bën etj., që i hasim mjerisht të publikura nëpër faqet e shtypit tone.

Konstruksione arbitrare etimologjike janë edhe ato që ofrojnë një emër vendi me një apelativ të paqenë në trup të tij: *Korab* me *korb*, *Prishtinë* me *prish –stinë* e me prijë (are), *Trepçë* me *tre*, latin me *latoj*, emrin vetjak *Vlladimir* me *vëlla-di – mirë* etj., të disa titullarëve me grada të larta shkencore në fushën e filologjisë, të historisë etj., të cilët me mediokritetin e tyre primitiv e me «atdhetarizëm» pararomantik

kujtojnë se i sjellin diçka të mirë albanologjisë, e në të vërtetë i bëjnë dëm shkencës sonë.

Me zbatimin e një metode pune të këtij lloji, me krahasime teke, të izoluara – sikundër thekson prof. Çabej, çdo gjë mund të krahasohet me gjithçka. Pseudoetimologët nuk mendojnë pakëz që në rrjedhë zhvillimesh gjuhësore që kanë zgjatur me mija vjet, shumë sende kanë ndryshuar nga shumë herë. Sikundër shprehet prapë patriarku i albanologjisë shkencore, prof. Çabej, në punë të etimologjisë vlen aksioma – *sa më e madhe të paraqitet gjaësia e dy pjesëve të barazimit, aq më e vogël është evidenca e drejtësisë së tij; sa më të largë në kohë, aq më pak evidente paraqiten krahasimet gjuhësore.*

Në punë të hulumtimit gjuhësor e shkencor duhet të jemi të sistemuar e kritikë, në kuptimin e asaj që thoshte prof. Selman Riza: *Unë jam në radhë të parë gjuhëtar kritik. Po me hoqën kritikën shkencor, unë nuk jam më Selman Riza.*

Së fundi, të kujtojmë këtu edhe fjalën porosi të albanologut të shkollës vjeneze, dr. Gjergj Pekmezit, i cili thoshte: *Të mblidhet në popull thesari i shqipes dhe të vihet mbi një bazë shkencore të mirëfilltë, duke i vënë pendë lumit të tërbuar të literaturës sonë, që po bie gjithë atë ledh e llom.*

### **Etimologjia «patriotike» a la sllavçe**

Në shtjellimet etimologjike onomastike kampionë të marrëzisë na dalin sidomos autorët sllavomaqedonas, qoftë ata me tituj të lartë shkencorë, e qoftë ata pa tituj – por me bagazh patologjik sllavofilie. Autorët e kësaj provenience, me ndonjë përjashtim, në «shkencën» e tyre të re të quajtur «Maqedonistikë», kanë futur në të çdo gjë jo shkencore dhe asnjë element shkencor.

Etimologët sllavomaqedonas, shumica syresh, marrin e shpjegojnë çdo gjë me gjithçka, krejt sipas shijeve të tyre «patriotike» maqedonomëdha. Edhe glosa të greqishtes, ilirishtes, trakishtes, pellazgishtes, makedonishtes josllave etj., të periodës antike e paraantike, i shpjegojnë me mjete gjuhësore të «maqedonishtes» të sotme sllave, si p.sh.: *Orfej*, nga *oros* «gora» (mal) e *fej* «pej» (këndoj), d.m.th. «gorskiot pejaç» (këngëtari i malit), *Iliada*, nga maq. *ilij* «sonce» (diell), *Akropol*, nga *kraj* (fundi) e *pol* «grad» (qytet), *Korinth*, nga *kora* (koritë), *Ohrid*,

nga *ohra* «crvenica» (i.e kuq) e *rid* (kodër ) etj. (Dr.Tashko Belçev, *Drevnata makedonistika denes*, «Vreme», Nezavisen informativno-politički njuzmagazin, nr.18, 2001).

Autorët sllavë në kërkimet e tyre «etimologjike» kanë qenë dhe janë posaçërisht të angazhuar që çdo toponim në Ballkan e në truallin shqiptar ta shohin në dioptrinë sllave dhe të mohojnë kësisoj elementin shqiptar. Ata kërkojnë «emra maqedonas» (makedonski iminja) të vendeve edhe në Shqipëri (K. Peev), paçka se emra të tillë nuk ka as në «Maqedoni». Sipas hulumtimeve të profesorit rus Afanasij M. Selishçev *Slavjanskoe naselenie v Albanii*, (Sofje, 1931) kryeideologut për pansllavizëm, atij i dalin atje – në rrethinat e Shkodrës – fare pak toponime shqiptare kundruall numrit të madh të toponimeve sllave – «në 40 topikë sllavë vijnë vetëm katër toponime shqiptare», apo nga 1200 topikë sllavë vetëm 120 na qenkanë shqiptarë (!).

Edhe ato «pak» toponime shqiptare, në truallin shqiptar, i gjejnë të përkthyer nga topikët gjegjëse sllave, si: *Mali i Zi* nga *Crna Gora*, *Mali i Thatë* nga *Suha Gora*, *Ujmir* nga *Dobrovoda*, *Vau* nga *Brodec* etj., - paçka se është krejt e kundërta, kurse në gjithë truallin e Maqedonisë ata pranojnë se ka vetëm 1 (një ) topik me prejardhje shqiptare – emri i fshatit malor Qafë në rrethinën e Kërçovës (J.Trifunoski)!

Disa «etimologë» të tjerë sllavë edhe emrin antik të *Sharrit* plak (Scardus Mons) e çojnë te sll. šara «pila» (sharrë), sepse ashtu ua do qejfi. Me kësofarë etimologjish fëmijnore të çuditshme (çudaçki etimologii – B. Koneski) ata shpjegojnë edhe emrin e botës sllave *Muhamed* me fjalë të sllavishtes *muha* e *med* (mizë mjalti), fjalën *akademi* me burim nga greqishtja e çojnë te burimi sllav *ukadomija* «dom na ukata» (sh. B. Koneski, *Jazikot i narodnata etimologija*, te Makedonski mesta i-iminja, Studensti zbor, Skopje, 1981).

Me etimologjitë e tilla sllave natyrisht nuk shkohet as te «dera e vogël» dhe ato as që meritojnë të merren në shqyrtim, por i sollëm këtu si shembuj sesi nuk duhet të merret dikush me këtë punë «të zezë». Kjo është një sëmundje e atyre që jetojnë larg shkencës dhe qytetërimit dhe u duket se bëjnë diçka.

Qemal MURATI

## ETYMOLOGY

### Summary

In etymology often co-operate two opposite tendencies: the explanation of the word genesis by means of the so-called *good will* and of the *strict scientific judgement*.

In this paper, the author opposes to the Albanian 'courageous' amateur 'etymologists', and also to Slavic-Macedonian 'etymologists', who do not abide by linguistic laws and rules, but speculating with casual phonetic resemblances of the words, they aim to 'clarify' their etymons. In this case, the author stigmatises many high ranking scientific figures, which with their primitive mediocrity and pre-romantic nationalism cause more harm to science than they think.